



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Posaçëm për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.03.2018, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Oerd Bylykbashi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Seancë dëgjimore me Open Data Albania, Aleancën Gjinore për Zhvillim, si dhe Fondacionin Shqiptar për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Ermonela Felaj, Musa Ulqini, Enkelejd Alibeaj, Dashamir Shehi, Luan Rama dhe Nard Ndoka.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Gent Strazimiri, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Nasip Naço, Vangjel Dule dhe Fatmir Mediu.

Të ftuara:

Aranita Brahaj – drejtore e Open Data Albania

Mirela Arqimandriti – drejtore ekzekutive e qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Blerta Cani – përfaqësuese e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

HAPET MBLEDHJA

Oerd Bylykbashi – Hapim seancën e sotme dëgjimore, sipas përcaktimit të bërë në rendin e ditës, për të cilën janë ftuar si pjesëmarrës përfaqësuesit e organizatave: Open Data Albania, e cila është përfaqësuar nga zonja Arianita Brahaj, e cila është prezente; qendra “Aleanca gjinore për zhvillim”, e përfaqësuar nga zonja Mirela Arqimandriti, e cila është prezente, si dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, përfaqësuar nga zonja Blerta Cani, e cila nuk është prezente.

Si fillim, dua të falënderoj për prezencën në këtë seancë dëgjimore përfaqësuesit e OSBE-ODIHR-it, çka është tregues shumë i qartë i gatishmërisë për të na asistuar në mënyrë intensive në këtë fazë të rëndësishme tonën dhe në vazhdim!

Në bashkëpunim me prezencën e OSBE-ODIHR-it, Këshillin e Europës, Komisionin e Venecias, Bashkimin Europian, si dhe partnerët e tjerë, kemi qenë në gjendje të detajojmë më tej planin tonë të punës. Ndaj do të doja që, para se të fillonim seancën dëgjimore, t’ju informoja shkurtimisht për materialet që kolegët e nderuar kanë përpara.

Plani i punës, i miratuar në seancën plenare të 14 shkurtit të vitit 2018, tashmë është i plotësuar edhe me datat ose periudhat kur ne sugjerojmë të mbledhemi. Sigurisht, mund të ketë nevojë për t’i detajuar më tej datat specifike të eventeve, por ky është kalendari i veprimeve të komisionit për të gjashta çështjet me të cilat komisioni do të merret me prioritet.

Gjithashtu, bashkë me matricën, me planin e punës përpara keni edhe një kalendar, i cili ju tregon, në mënyrë të qartë, shpërndarjen në muajt e ardhshëm të aktiviteteve të planifikuara sipas planit të punës, të miratuar më 14 shkurt, pra të të gjitha fazave të tyre, duke filluar nga fazat kërkimore për të vazhduar me dokumentet që përgatiten, *workshop*-et teknike të komisionit apo konferencat ndërkombëtare që do të zhvillohen, më pas janë raportet përkatëse dhe detajimi i qëndrimeve politike nga komisioni në lidhje me çështje të caktuara para se të fillojë procesi i draftimit.

Pra, në këtë kalendar ju shihni këtë kohështrirje, i cili është hartuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, që po ofrojnë asistencë dhe me të cilët do të vazhdojë detajimi. Por më konkretisht për datat specifike, sipas eventeve, do t’ju njohim nëpërmjet mbledhjeve në vijim.

Unë besoj se me këto dy dokumente: planin e punës dhe kalendarin, ne kemi të gjithë hapësirën që të vazhdojmë përpara me intensitet dhe me koordinim për gjashtë pikat kryesore të punës.

E theksoj sërish, kjo është pjesa e nevojshme në lidhje me trajtimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it dhe çështjeve të mëdha, që kanë një lloj urgjence, por komisioni ka një qasje dykohëshe: do të merremi menjëherë me trajtimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, për ato që janë të nevojshme për zgjedhjet e ardhshme, ndërsa më vonë komisioni do të ketë hapësirën për të diskutuar edhe çështje të tjera, që nuk janë urgjente për vitin 2019, si, për shembull, lidhur me sistemin zgjedhor, referendumin apo çështje të tjera, që janë ngritur edhe nga anëtarët e komisionit apo edhe nga subjekte që përfaqësojnë këtë komision. Pra, ky komision nuk e mbyll punën këtu te këto gjashtë çështje.

Gjithashtu, përpara kemi një tabelë, ku janë të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it të viteve 2013, 2015 dhe 2017, përgatitur nga prezenca e OSBE-së. Ky dokument do të na ndihmojë për të pasur nën kontroll punën që ne duhet të bëjmë në lidhje me këto rekomandime.

Në kuadër të detajimit të punës sonë, ne do të shohim edhe detajime më konkrete në raport me këto rekomandime, për të parë nëse mund të shkojmë edhe më thellë se kaq.

Gjithashtu, kemi edhe një përmbledhje të rekomandimeve të përsëritura të OSBE-ODIHR-it. Ka ardhur koha që ne t'i trajtojmë me fokus këto rekomandime që përsëriten, çka tregon qartë jo vetëm një shqetësim të OSBE-ODIHR-it, por do të thotë se kemi një problem persistent në procesin zgjedhor dhe duhet t'i trajtojmë nëpërmjet këtyre pikave të planit të punës që kemi.

Ky ishte një prezantim i materialeve që keni përpara. Nëpërmjet këtij planifikimi të detajuar, faktit se partnerët ndërkombëtarë kanë disponimin e plotë për të na dhënë mbështetje me ekspertë për të financuar të gjitha eventet që ne zhvillojmë, besoj se ndaj të njëjtin opinion me bashkëkryetarin Çuçi, që ne do të kemi mundësi së bashku të ecim me hap intensiv.

Siç kemi rënë dakord më herët, do të caktojmë edhe deputetët që do të ndjekin çështje të caktuara gjatë zbatimit të tyre, si reporterë të komisionit në raport me punën që bëjnë ekspertët apo grupet e punës që do të ngrihen. Kjo do të jetë në një fazë tjetër.

Nëse ka ndonjë çështje lidhur me këtë, të nderuar kolegë, jeni të mirëpritur.

Nuk keni gjë?

Atëherë, pas kësaj pjese informuese, vazhdojmë më tej.

Le të hapim tani seancën dëgjimore fillimisht me organizatën “Open Data Albania”, përfaqësuar nga zonja Arianita Brahaj.

Besoj se koha prej 15 minutash bashkë me pyetje-përgjigjet është e mjaftueshme. Megjithatë, po të keni nevojë për më shumë, këtu jemi.

Faleminderit!

Arianita Brahaj – Mirëdita!

Ju falënderoj për ftesën që u keni bërë përfaqësuesve të shoqërisë civile për të qenë pjesë e dëgjësës dhe e konsultimeve në kuadër të punës së komisionit tuaj!

Paraprakisht do të prezantohem. Unë drejtoj organizatën “Instituti Shqiptar i Shkencave”, por ne njihemi me emrin “Open Data Albania” për shkak të projektit të parë dhe kryesor, që ka qenë për promovimin e të dhënave të hapura.

Organizata ku unë punoj është e regjistruar pranë gjykatës dhe ka për mision aktivitetet që kanë të bëjnë me promovimin e të dhënave të hapura, transparencës, llogaridhënies dhe mirëqeverisjes.

Ne kemi qenë të angazhuar në problematikat zgjedhore nëpërmjet dy projekteve tona: “Para, pushtet dhe qeverisje” (Money, Government dhe Politics) dhe ‘Zalard’.

Gjithashtu, në dy fushatat e fundit zgjedhore ne kemi qenë pjesë e iniciativës “Dhoma zgjedhore”, nismë kjo e disa organizatave, për një monitorim dhe advokim për çështjet e të drejtave zgjedhore.

Organizata që unë drejtoj e sheh me vend të sjellë para jush disa çështje për diskutim dhe propozime që kanë të bëjnë me nenet e Kodit Zgjedhor, që rregullojnë çështjet e financimit të fushatave zgjedhore, pasi kjo është edhe ekspertiza jonë më e saktë.

Një tjetër aktivitet i organizatës është edhe një proces gjyqësor që ne kemi, dhe tashmë jemi në Gjykatën e Lartë, me tri parti kryesore politike, të cilat janë në cilësinë e subjekteve elektorale, duke pretenduar prej tyre të drejtën për informim në kohë reale për financat, kryesisht për donacionet e fushatave zgjedhore.

Rekomandimet apo çështjet që unë do të shtroj janë të ndara në 12 pika.

Preferoni që pas secilës pikë të bëjmë një kërkesë për sqarim apo pyetje, çka do të ishte e mundur, apo preferoni që t’i parashtroj të dymbëdhjeta?

T'i parashtroj të gjitha? Në rregull.

Atëherë, pika e parë, gjithmonë lidhur me financimet e fushatave zgjedhore, ka të bëjë me kërkesën për dhurime vetëm nëpërmjet llogarive bankare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si, ju lutem?

Atëherë, ne do ta shihnim me vend të ndryshohej neni 90/2 e Kodit Zgjedhor, ku aktualisht është parashikuar që vetëm donacionet, të cilat janë për vlera mbi 100 mijë lekë të rinj të bëhen me llogari bankare dhe me detyrimin për regjistrim në një regjistër të veçantë.

Duke qenë se donacionet anonime, nëse mund t'i quajmë me një fjalë të thjeshtë të tilla, në fushatat e fundit zgjedhore, që nga viti 2009, deri në fushatën aktuale, kanë një peshë të mirë te disa subjekte elektorale, por në tërësi të financimet e fushatës, arrinte një herë deri 50% të totalit të fondeve që vijnë nga fonde jopublike. Mendojmë se do të ishte mirë që ligjvënësi ta konsideronte këtë lloj detyrimi.

Nëse jo, për çdo lloj të ardhure ose donacioni, pra për çdo lloj vlere, duke filluar që te vlera 1 lek, të paktën të konsiderohej një brez te 100 euro apo 150 euro e lart. Kjo do ta bënte fushatën më transparente, më llogaridhënëse dhe financimin e saj. Dhe kjo përkon me një ndryshim të nenit 90/2.

Pika e dytë ka të bëjë me informimin në kohë reale mbi donacione monetare të fushatës. Në fakt, po t'i referohemi paragrafit 3 të nenit 9 të Kushtetutës, është e parashikuar që burimet financiare të partive politike, si dhe shpenzimet e tyre, të bëhen kurdoherë publike. Shprehja "kurdoherë publike" thjesht të interpretohej që çdo fakt është i kërkueshëm si informacion ose është e drejtë për t'u kërkuar, të jetë i aksesueshëm për publikun në çdo moment që ky fakt ose ky argument ka lindur. Por, ndërkohë, interpretimet që janë bërë edhe nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, edhe nga Gjykata Administrative e nivelit të parë dhe Gjykata e Apelit, sikurse edhe interpretimet që janë dhënë nga përfaqësuesit e partive politike, të cilët kanë ardhur në procesin gjyqësor, kanë qenë që ky nuk mjafton për ta pasur këtë kërkesë dhe për ta legjitimuar.

Unë mendoj se është rasti që ligji, pra Kodi Zgjedhor, ta shikojë më me kujdes aksesin e informimit në kohë reale për donacionet dhe për burimet e të ardhurave të partive politike gjatë fushatës zgjedhore.

Duke qenë këto llogari bankare në dispozicion të publikut online apo të përditësuara në ditën e parë të fillimit të fushatës zgjedhore apo me një kronologji pesëditore apo njëjavore, mendojmë se ky është një element për t'u parë.

Ka edhe një gjë, që unë do të doja ta theksoja: ndryshimet e Kodit Zgjedhor, që janë bërë në vitin 2012, kanë hequr një fjali në paragrafin e parë të nenit 90 (ishte fjalia e fundit, që ka qenë në këtë nen): “Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, duhet të bëhet kurdoherë publike”.

Me ndryshimin e ligjit në datën 19.07.2012 “Kodi Zgjedhor”, kjo fjali është hequr, duke krijuar regres në të drejtën për informim publik lidhur me mbështetësit e një partie politike, nëpërmjet donacioneve, edhe përpara datës së votimit. Pra, nuk e di, nuk kam gjetur asnjë relacion të punimeve të Kuvendit dhe të ligjvënësit të mëhershëm pse është konsideruar kjo heqje e kësaj fjalie, por mendoj dhe propozoj që do të duhet të konsiderohet ky akses për informim në kohë reale. Edhe ligji “Për të drejtën e informimit” jep hapësira për ta pasur të drejtën për të kërkuar informacion në kohë reale dhe në momentin që informacioni ka lindur.

Pika e tretë është tepër interesante, sepse është edhe mjaft aktuale për shkak të ndryshimeve që ka bërë ligjvënësi në maj të vitit 2017, për shkak të marrëveshjes politike mes partive. Ne propozojmë të shmanget me parashikim të qartë ligjor çdo marrëdhënie donacioni, subvencioni, ndihme apo kreditimi ndërmjet subjekteve elektorale me subjektet medietike.

Neni 89, që parashikon konfliktin e interesit, e përjashton subjektin që ushtron veprimtari medietike ose është aksioner në një subjekt të tillë, nga e drejta për të qenë donator i një subjekti elektorale.

Kjo është mjaft korrekte në respekt të parimit të pavarësisë së medias dhe ndarjes së këtyre dy pushteteve, pra pushteti politik, i cili më vonë përkthehet në pushtet legjislativ dhe ekzekutiv, dhe pushteti i medias, i cili njihet, legjitimohet. Nga ana tjetër, kemi një tjetër nen të Kodit, që është neni 84, paragrafi 6, i cili krijon një burim financiar shtesë për partitë e rëndësishme politike. Them të rëndësishme, në vlera.

Media detyrohet me ligj të dhurojë një pjesë (“të dhurojë”, “të subvencionojë”, “të ofrojë” ose “me pagesë”) janë sinonime dhe mendoj se secili prej tyre është i qartë të minutave të partive që kanë konsumuar kundrejt pagesës një kohë të caktuar reklame. Propozojmë që ky nen të shfuqizohet, pasi krijon një marrëdhënie dhurimi kontradiktore me rregullimin e nenit 98;

krijon vështirësi në monitorim, pra kush do ta monitorojë: tatim-taksa, KQZ-ja, bordi i monitorimit të medias, a do të jetë transparent dhe i koordinuar monitorimi? Pra, është përdorur në mënyrë arbitrare edhe në zgjedhjet për pushtetin vendor, megjithëse ligji shprehet qartë, dhe këtë fakt unë e kam nga raportet e auditimit të fushatave zgjedhore ndër vite. Pra, në ligj shprehet qartë se kjo duhet përdorur vetëm për zgjedhjet e përgjithshme, por, në fakt, është përdorur edhe për zgjedhjet e pushtetit vendor.

Nuk jemi në situatat kur partitë kanë mungesa dhe vështirësi në mbulimin e kostove financiare të reklamës. Reklama politike është bërë tepër masive dhe ky është një perceptim yni, ndoshta i bazuar edhe në raporte monitorimi, pra është tepër masive dhe do të ishte mirë që çdo subjekt politik të orientohet drejt cilësisë së mesazhit të reklamës dhe jo sasisë.

Gjithashtu, jemi në kontekste, ku media audiovizive nuk qëndron ngushtësisht në cilësinë e medieve të licencuara si medie kombëtare, por ka forma të ndryshme dinamike të emetimit audioviziv, bazuar edhe në teknologjitë e reja. Mendoj se është pak e superuar që një kategori e caktuar mediesh ta ketë këtë detyrim, ndërkohë që një kategori tjetër, me shumë impakt, nuk është fare e rregulluar në kontekstin e ligjit.

Po kaq i gabuar dhe kontradiktor konsiderohet edhe rregullimi për reklamën pa pagesë, i bërë me ndryshimin në ligjin “Për partitë politike” (ajo pjesa e marrëveshjes), i cili, në fakt, binte edhe ndesh me Kodin, përveçse kufizonte një liri kontraktore mes dy palëve, që, në fund të fundit, vetëm marrin një shërbim.

Kodi i ri Zgjedhor do të duhet të respektojë, në mënyrë shteruese, ndalimin e pozicionit të donatorit për subjektet medietike, të cilat duhet të jenë palë e partive dhe subjekteve elektorale vetëm nëpërmjet kontratave tregtare të mirërregulluara, të cilat do të ishte mirë të ishin, gjithashtu, të aksesueshme nga publiku në rastin e kontraktimeve në fushatë zgjedhore.

Po kështu, duhet parë me kujdes edhe situata e faturave të papaguara dhe situatave debitore me medien. Subjektet tregtare kanë të drejtën e tyre të kërkimit të detyrimeve, por kur subjekti debitor është një parti politike me pushtet, kërkimi i debive është një çështje e mundshme intimidimi dhe influence. Pra, jemi në rastin që një parti politike nuk ka shlyer një detyrim kontraktor të faturuar dhe të njohur për një subjekt, që në rastin në fjalë, po themi, është media, por subjekt mund të jetë edhe një palë tjetër. Dakord, një faturë është e drejtë e palës, e cila e ka lëshuar dhe i është njohur që ta kërkojë nëpërmjet legjislacionit tregtar ose të drejtës

civile, por jemi në rastin e një rregullimi që bëhet me ligj, sepse kemi rastin e kontraktimeve për fushatë, dhe jemi në rastin kur kemi të bëjmë me subjekte të rëndësishme, të cilat marrin pushtet, madje janë subjekte edhe të kontrollit të influencës, siç janë partitë politike, që më pas bëhen ligjvënës ose ekzekutiv.

Mendoj se ka vend të shikohet mundësia e rregullimit të kësaj edhe nëpërmjet disa parashikimeve dhe kompetencave për KQZ-në, ku në rastet e faturave të papaguara, të debive, të cilat me kalimin e kohës mund të kthehen në kredi apo në donacione, KQZ-ja, në shpërndarjen e fondit vjetor apo fondit të ardhshëm për partitë politike, të ketë parasysh që mund të bëjë edhe ekzekutime për debi të njohura dhe të deklaruara edhe nëpërmjet raportimit financiar apo auditimit financiar të partisë politike.

Një problematikë e tillë ka qenë edhe për rastin e detyrimeve vjetore që kanë subjektet, partitë politike (në fakt, kjo nuk është pjesë e Kodit, por e ligjit “Për financimin e partive politike”) ndaj ekspertëve kontabël, të cilët, pasi bënin auditimin, të kontraktuara nga KQZ-ja dhe të vëna në dispozicion të partive politike, nuk merrnin detyrimin, pagesën e tyre të faturës së shërbimit. Kjo e vendoste në një marrëdhënie negative edhe procesin, i cili ishte i rregulluar me ligj, pra procesin e auditimit të fondeve të partive politike.

Pra, ky element ndoshta del jo vetëm në kontekstin e marrëdhënies së medias, si subjekt, dhe subjekteve elektorale, por edhe të rregullimit të detyrimeve dhe të interpretimit të saktë të rastit kur një faturë e papaguar krijon një marrëdhënie donacioni, kreditimi apo debie (borxhmbajtje).

Po kaloj te një pikë krejt tjetër, që është një rregullim më efikas i rasteve të parashikuara si konflikt interesi për donatorët. Ligji i parashikon, por kemi dy problematika.

Së pari, ligji do të duhet të ndryshojë, të jetë edhe më efikas dhe më aktual. Kështu, për shembull, do të ishte mirë të vendoset parashikimi ligjor më i zgjeruar për parandalimin, deklarimin dhe kontrollin e konfliktit të interesit për donatorët, ku Kodi Zgjedhor, nëpërmjet nenit 89, parashikon disa situata, por ky nen kërkon rregullim dhe zgjerim. Konkretisht, për shembull, fjala “aksioner” do të ishte mirë të zëvendësohej me fjalën “zotërues”, sepse me aksioner kemi lënë, kemi përjashtuar ortakët e një kompanie ose të një subjekti.

Përveç parashikimit për kontrata dhe fonde publike, të parashikohet si konflikt interesi edhe rasti i përfitimeve nga programet e subvencionit publik, kreditimit të garantuar me fonde

publike. Pra, edhe këto subjekte të jenë të përjashtuar nga e drejta për të qenë donatorë pa konflikt interesi: përfitues nga privatizimet e asetëve publike, qofshin këto privatizime të aksioneve të kompanive publike apo të pasurive të caktuara të patundshme nëpërmjet privatizimit; përfitues nga legalizimet për vlera të caktuara. Pra, vlera mbi 10 milionë, që është e parashikuar për rastet e tjera, do të ishte me vend.

Përfitues nga programe publike në dobi të biznesit. Gjithashtu, do të doja të propozohej edhe përfitues të licencave publike, sepse edhe kjo është një formë përfitimi apo influence që do të duhet të vendoset në rregull, përveç atyre që janë të parashikuara tashmë.

Një tjetër kërkesë është që do të donim shumë që parashikimi ligjor të ishte i saktë dhe orientues për verifikimin administrativ për rastet e konfliktit të interesit. Aktualisht, ne i kemi të parashikuara rastet e konfliktit të interesit, por nuk e kemi parashikuar nëse ka ndonjë mënyrë për të bërë ndonjë investigim, qoftë ky administrativ dhe, nëse ka, kush dhe si duhet ta bëjë.

Propozimi ynë është që KQZ-ja të kishte një kompetencë për verifikim dhe hetim administrativ nëpërmjet kërkesave për informacion pranë institucioneve publike në lidhje me respektimin e parashikimit të ndalimeve të konflikteve të interesit. Verifikimi mund të bëhet pranë tatimeve për debitorët; pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike për kontratat publike; pranë regjistrat koncesionar për kontratat koncesionare e kështu me radhë.

Dua të shpjegoj që ne jemi një shtet fatlum, sepse kemi kaq shumë sisteme elektronike dhe verifikimi nuk është gjë tjetër veçse një proces vullneti dhe metodologjie, se nuk jemi në momentin, për shembull, që lista e debitorëve të tatim-taksave mbahet në mënyrë krejt të decentralizuar apo lista e përfituesve të prokurimeve publike nuk është në një sistem. Pra, ne i kemi këto sisteme falë investimeve që ka bërë qeveria apo edhe donatorët. Sistemet janë në të disatin vit të testimit të tyre dhe nuk kemi asnjë arsye pse të mos e vëmë në lëvizje për ndonjë investigim administrativ, të cilin do të propozoja që të ishte kompetencë e KQZ-së.

Gjithashtu, duhet të parashikohet edhe sanksion për ata individë apo donatorë, në rast të deklarimit të rremë për mospasjen e konfliktit të interesit, pra një sanksion që është mirë të parashikohet në Kod se si do të jetë, bashkë me sanksionet e tjera për shkelje të tjera nga subjektet.

Kemi parasysh se konflikti i interesit rregullohet ose është kompetencë e një institucioni të caktuar, por donatorët nuk janë subjekt i verifikimit të ILDKPKI-së. Ndaj, mendoj se në këtë

rast një propozim i qartë (ILDKPKI-ja është ajo që përmbledh konfliktin e interesit në kontekstin e administratës publike) do të ishte KQZ-ja dhe ekzistojnë mundësitë për ta pasur një modalitet të tillë.

Kërkesa e gjashtë, dhe këtu arrij te gjysma e propozimeve, ka të bëjë me afatet më realiste të periudhës nën raportim të fushatës zgjedhore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Afate më realiste do të thotë që fushata nuk është tridhjetë ditë, as detyrimi për ta njohur, për ta lëshuar dhe për ta paguar një faturë sipas parimeve të kontabilitetit dhe rregullave, apo standardeve të kontabilitetit nuk është i kufizuar në tridhjetë ditë.

Nëse duam një raportim realist, do të ishte mirë të krijojmë një hapësirë më të gjatë kohore. Është bërë një përpjekje e tillë në rregullimet e muajit maj, në mos gaboj, ama kjo përpjekje nuk vlen në qoftë se është një rregullim me ligj dhe nuk është i vendosur në Kod.

Unë do të propozoja që afati të jetë i shtrirë edhe më përpara, pra që me datën e shpalljes së zgjedhjeve, edhe pas datës së votimit, pasi faturat mund të lëshohen edhe në datën e fundit të zgjedhjeve dhe për t'i administruar, për t'i njohur, për t'i lëshuar me kujdes, për t'i paguar ato duhet njëfarë kohe. Prandaj mendoj që, në qoftë se u japim mundësi palëve ta kenë informacionin në kohë reale për disa elemente të financës dhe, nga ana tjetër, u japim kohë partive të bëjnë një përmbledhje dhe një raportim shterues edhe më të qartë të financave zgjedhore, nuk është një proces që nuk na sjell rezultat.

Ka një nen në Kodin Zgjedhor, që bën kufizimin e totalit të shpenzimeve zgjedhore dhe mendoj se është i pabazuar, sepse pretendohet që partitë nuk mund të shpenzojnë më shumë se dhjetë herë nga ajo çka kanë marrë nga financimet publike, por shikoj që partitë politike në një fushatë modeste, siç ishte fushata e fundit zgjedhore, pra ajo e vitit 2017, kanë shkuar në nivele të larta deri në 100 e ca milionë lekë të rinj, po them se ka deklaruar një subjekt politik. Ndërkohë, ne kemi perceptimin se fushata të tjera janë edhe më të kushtueshme. Në qoftë se e heqim këtë limit, u japim një shans partive të deklarojnë, në mënyrë më realiste, nëse vërtet kanë shpenzime më të mëdha. Gjithashtu u japim një mundësi partive politike ta konsiderojnë me kujdes edhe faktin që mund ta përdorin mundësinë ose kapacitetin e tyre për të përthithur fonde jopublike, si një opion që ata të shprehin edhe se sa mbështetje kanë nga elektorati i gjerë jo

vetëm nëpërmjet votës, por edhe nëpërmjet dhurimeve, qofshin këto edhe vlera të vogla, të cilat, kur janë shumë, sjellin një shumatore të lartë.

Kërkesa e tetë është më shumë se sa një propozim, një opinion i dhënë nga organizata jonë: ruajtja e financimit miks (fonde publike dhe jopublike) për subjektet elektorale. Mendojmë se ky është një element që do të duhet të ruhet. Të dyja llojet e financimit kanë elemente pozitive dhe elemente të cilat kanë nevojë për kontroll, për vlerësime të kufijve dhe të masave, por mendojmë se kjo formë mikse do të duhet të ruhet dhe të respektohet. Kjo edhe për arsyen se nëse partitë politike do të financoheshin vetëm me një lloji fondesh, pra vetëm me fonde publike, do ta kishim shumë të kollajshme ta perceptonim partinë si e kontrolluar nga financa dhe buxheti i shtetit, ashtu sikurse çdo qytetar do të thoshte: “Unë jam një taksapagues dhe nuk dua të kontribuoj me taksat e mia në financat e një partie apo të disa partive politike që mua nuk më përfaqësojnë dhe duhet të bëjnë përpjekjet e tyre për të përfaqësuar nëpërmjet programeve dhe mesazhit politik”. Ky është një opinion yni, që besoj se do të konsiderohet. Ne mund t’ju sjellim edhe argumente të tjera pasi në një *policy paper* që kemi bërë më përpara për këtë çështje, i kemi pasur të detajuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi pikën nëntë, e cila përkon me ndryshimet që i janë bërë ndër vite Kodit Zgjedhor. Për shembull, ne kemi një rregullim, por do të duhet të jetë më i qartë, për burimin e financimit nëpërmjet kredive dhe deklarimit të të dhënave të kreditimit nëpërmjet një regjistri të posaçëm.

Pra, kemi fenomene që partitë e kanë të drejtën të marrin kredi, ama do të duhet të parashikojmë qartë, nëpërmjet ligjit, që të bëhet edhe deklarimi i të dhënave të kreditimit, duke paracaktuar dhe listuar kategoritë e të dhënave për deklarim. Për shembull, vlera e kredisë, garantët e kreditimit, kushtet, afatet e kredisë, barra siguroese, forma e aplikimit, të dhënat e identitetit të subjektit kreditues. Duhet parashikuar qartë: a duhet të merren kredi në institucione jo të licencuara për veprimtari financiare dhe a duhet saktësuar nëse lejohet ose jo kreditimi apo grantimi i subjektit nga subjekte ose entitete të huaja?

Besoj se kjo e drejtë për të pasur një burim financimi nëpërmjet kredive u njihet partive politike nga neni përkatës në Kodin Zgjedhor, por do të duhet tani të kemi edhe modalitete të qarta se si do të kreditohen dhe si do të deklarohen të dhënat e një procesi kaq të rëndësishëm që u siguron partive mjete financiare për të zhvilluar fushata elektorale.

Pika dhjetë kërkon të konsiderohet mundësia për raportim financiar edhe sipas degëve të partive politike për rastin e zgjedhjeve të përgjithshme dhe sipas shtabeve të kandidatëve për kryebashkiak në rastin e zgjedhjeve lokale.

Do të ishte një proces shumë realist, sepse ne e dimë shumë mirë që në zona të caktuara dhe në kandidime nominale të caktuara fushatat marrin dimensione dhe përmasa të ndryshme të promocionit, të investimit elektoral, të shpenzimit elektoral.

Meqenëse jemi në kuadrin që po bëjmë rregullime për procesin e ardhshëm zgjedhor, i cili është një proces për pushtetin lokal, dhe nga hulumtimi që i është bërë, zgjedhjet e fundit për pushtetin vendor kanë pushtuar ose kanë qenë edhe më të spikatura në shpenzime se sa zgjedhjet e përgjithshme, do të ishte me vend të shikonim mundësinë që raportimi i subjekteve elektorale të bëhej edhe në bazë të shtabeve apo të degëve gjeografike elektorale. Për rastin e zgjedhjeve të përgjithshme do të ishin qarqet, ndërsa për rastin e zgjedhjeve lokale do të ishte shumë mirë sipas bashkive dhe sipas kandidatëve, duke parashikuar, pse jo, edhe një deklaram individual të kandidatit, pavarësisht se ai është kandidat i një partie politike, për donacione, dhurime apo shpenzime të tij individuale në funksion të fushatës.

Pika njëmbëdhjetë nuk është një propozim, por është dëshirë për ta pasur në vëmendjen tuaj si ligjvënës, një element që po diskutohet në mjaft vende të tjera të Europës apo të rajonit. Kështu që, unë mendoj se ligji zgjedhor, Kodi, do të duhet ta vlerësojë qartë nëse pranon dhurime nga subjekte të regjistruara si organizma jofitimprurës, pra joqeveritarë.

Po të pyesësh të gjithë deputetët apo kolegët e mi që punojnë në shoqërinë civile, perceptimi është që organizatat nuk mund të bëjnë dhurime për partitë politike. Në fakt, po të shohësh kodin dhe disa pjesë të tjetra të legjislacionit, e kupton që ka disa ndalime, por ato nuk janë ndalesa shteruese. Pra, ka një parashikim që organizatat nuk mund të dhurojnë për propagandë elektorale, por shpenzimet elektorale nuk janë vetëm për propagandën, sepse ka konsulenca, infrastruktura, mund të jenë elementë të lobimit në të cilat organizatat mund të dëshirojnë shumë që një parti të fitojë, nëse partia është angazhuar të plotësojë disa objektiva, të cilat përkojnë edhe me programin apo misionin e vetë organizatës.

Do të doja shumë që ju, si ligjvënës, ta konsideronit dhe ta shprehnit qartë në ligjin zgjedhor, nëse jemi në rastin kur duhet pranuar dhe nëse do të pranohet, si do të jenë rregullat.

Shqetësimi i dhënë nga disa organizata dhe disa subjekte të monitorimit në vende të ndryshme të Europës ka qenë për financimin e huaj, i cili bëhet i mundur edhe përmes financimeve indirekte përmes OJQ-ve, sepse ato kanë një liri për t'i fituar burimet e tyre financiare përmes fushatave *fond raising*, të cilat mund të bazohen në financime anonime, apo financime për shuma të caktuara joanonime, por gjithsesi, unë do të doja që juta keni në konsideratë dhe të keni një parashikim ligjor shumë të qartë dhe shumë parandalues për ndonjë situatë, si ajo që vendet e rajonit apo vendet e Europës po e kalojnë tashmë.

Pika 12, është që ligji të kërkojë raportim të saktë të shpenzimeve dhe të kontraktorëve në rastet, kur ato të jenë subjekte të huaja. Pra, e kemi rregulluar burimin e financimit nga subjektet e huaja, duke bërë ndalesat e duhura, por kemi parti politike ose subjekte elektorale, sepse në të ardhmen mund të jenë edhe kandidatët e pavarur, të cilët mund ta kenë mundësinë dhe opsionin, sikurse dëshirën dhe të drejtën të kontraktojnë entitete të huaja për të realizuar shërbime të ndryshme. Nëse për entitetet vendase ne e njohim të drejtën tregtare apo të drejtën që e rregullon bazën ligjore, e kemi të qartë se si mund të investigojmë dhe të njohim entitetin dhe domethënien e tyre.

Në rastin e kontraktorëve kjo nuk duhet të jetë absolutisht e kufizuar as në vlera, as në liri kontraktore, por duhet të jetë e rregulluar me nevojën për raportim në një formë të veçantë të identitetit të kontraktorit, të përkatësisë së të drejtave tregtare që rregullon ekzistencën e këtij kontraktori, të dhënave financiare të kontratës me palë të huaja dhe një objekt të qartë i kontratës. Kur them këtë, duhet të kemi parasysh që çfarë është lobim, të shënohet si lobim, çfarë është konsulencë të shënohet si konsulencë, çfarë është rritje kapacitetesh, të shënohet si rritje kapacitetesh, pra të kemi mundësinë dhe qartësinë për të bërë verifikimin e këtij elementi.

Ndoshta shtohen shumë elementë me këto 12 propozime që kam bërë.

Ju falënderoj për mundësinë! Ne do t'i dorëzojmë edhe me shkrim së bashku me një raport më të hershëm, në kuadër të punës sonë pranë Dhomës Zgjedhore, që e kemi referuar edhe më parë pranë administratës së Kuvendit, por e shohim me vend ta risjellim te ky komision.

Unë jam e hapur për ndonjë sqarim apo për ndonjë pyetje.

Ju falënderoj që më dëgjuat!

Mundet që shumë çështje kanë shumë më tepër ambicie sesa ...

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zonja Brahaj!

Ju falënderoj për prezantimin e çështjeve, që ju i konsideruat të rëndësishme, në mënyrë të veçantë për një nga çështjet që ka qenë vazhdimisht kohët e fundit që në vitin 2016 ka pasur një prioritet të rritur për reformën zgjedhore! Unë besoj që ju do të na sillni edhe materialin me shkrim për këto çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Kolegët mund të kenë pyetje. Kush ka pyetje?

Fjala për zotin Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Ju falënderoj për raportimin!

M'u duk vërtet serioz dhe kishte pretenduar të kishte vërtet një vështrim panoramik në sektorin e financimit të fushatave zgjedhore.

Nuk e di nëse ju jeni marrë, apo jo, lidhur me një sektor tjetër të financimit të fushatave kryesisht me shitblerjen e votës. Kjo është një mënyrë financimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni të mbaroj unë!

Unë të financoj duke të dhënë para dhe ti ma kthen mbrapsh duke më dhënë votën. Kaq e thjeshtë është.

Pyetja që kam për ju: Nëse ju jeni në dijeni të këtij fenomeni, sa i përhapur është ky fenomen? Përse ndodh dhe ajo që më intereson është: a ka mjete, mënyra, mekanizma dhe procese për ta dekurajuar (së paku), si proces? Nëse përgjigja është po, do të doja të dija opinionin tuaj.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Fjala për zonjën Brahaj!

Aranita Brahaj – Unë isha këtu për të propozuar disa rregullime, që kanë të bëjmë me financimin e fushatave zgjedhore dhe çështja që ju më pyetët, ka të bëjë me financimin e krimeve elektorale, sepse blerja e votës është krim elektorale. Patjetër që kjo është shqetësuese. Unë do ta çmoja shumë nëse ligjvënësi, edhe përmes ligjit që rregullon çështjet zgjedhore, parashikon mundësi për penalitete edhe më të rënda për rastin në fjalë. Fenomeni është i përhapur. Ne e kemi raportuar përmes projekteve tona (një nga projektet ka qenë **Zalard**). Ka

zona ku është edhe më i spikatur. Nëse do të më pyesnit se si mund të minimizohet, dy janë mënyrat: krimi elektoral ka nevojë për hetim dhe hetimi është penal.

E dyta, ka nevojë për parti politike që ofrojnë më shumë kandidatë përfaqësues ose ofrojnë më shumë programe, të cilat të pëlqehen nga publiku, kundrejt ofertës pragmatiste të datës së zgjedhjeve që mund të jetë një interes, një blerje, një shumë materiale.

Unë u përpoqa të jem e fokusuar te rregullat, që kanë të bëjnë me financimin dhe me disiplinimin e çështjeve të financimit.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Fjala për zonjën Felaj!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e dëgjova me vëmendje parashtrësën tuaj dhe gjëja që më tërhoqi realisht vëmendjen, ishte pjesa kur ju folët për shpenzimet e fushatave elektorale. Ju sugjeruat që limiti i sipërm nuk duhet të jetë që partitë politike apo subjektet e ndryshme të deklarojnë realisht sa shpenzojnë në fushatat e ndryshme.

Në gjykimin tim për një moment kjo edhe mund të rrinte, por gjithmonë nëse ne i kontrollojmë të gjitha burimet e financimit dhe kemi mundësi të dimë, që çdo lloj financimi është i pastër.

Duke marrë shkas edhe nga shembujt e fundit, ku po shohim që ka financime që bëhen nga jashtë, nga kompani të fshehura, nga kompani guackë, natyrisht nuk kemi mundësi të hyjmë dhe të kontrollojmë deri në fund se çfarë përfaqësojnë. Desha të di a i përmbaheni qëndrimit tuaj që nuk duhet të ketë limit apo mos ndoshta duhet të rrisim dyshtemenë dhe më pas të vendosim edhe një limit, që ky të jetë sa më i arsyeshëm?

Faleminderit!

Aranita Brahaj – Unë i përmbahem të dymbëdhjetë pikave që propozova, sepse ato të dymbëdhjeta (ndoshta ka edhe të tjera) dhe më vonë mund të vij të sjell apo të mbështes edhe propozime të tjera, duke i konsideruar si pozitive.

Unë mendoj se ky limit (gjithmonë, kur vendoset një limit mendon që ka diçka të gabuar deri te kufiri i limitit apo afër tij), nuk ka asgjë të gabuar që partitë politike të kenë burime financimi sa më dinamike dhe të jenë kompetente për ta artikuluar qartë këtë. Unë e

konsideroj mbështetjen financiare apo donacionet financiare ndaj partive politike, edhe si një mundësi për të shprehur çdo votues mbështetje ndaj subjektit elektoral.

Një parti do të ishte shumë e suksesshme, nëse do të vinte dhe do të thoshte se e ka rritur bazën e donatorëve, qoftë edhe në shuma të vogla, sepse mbështetja e bazës për mua, mbështetja e përgjithshme për mua është e madhe. Prandaj unë mendoj se nuk jemi në këto kushte.

Fakti që partitë në fushata jo të kushtueshme (fushata e fundit zgjedhore pati një periudhë shumë të shkurtër) dhe raportimi vjen dhe rritet. Partia juaj ka shkuar në nivelin 100 milionë lekë të reja për një fushatë, e cila nuk pati aq sa fushata e mëparshme shtabe, pankarta elektorale. Mund të themi që disa shpenzime ishin në miniaturë, pra nuk kemi kosto, të cilat të na duken dhe përsëri keni arritur një vlerë aq të lartë.

Mendo se çfarë do të ndodhë kur të keni 61 kandidatë dhe shtabe elektorale, të cilët do të bëjnë çmos (ata dhe baza që i mbështet), të krijojnë sa më shumë infrastrukturë elektorale dhe kur them këtë nënkuptoj edhe mjetet monetare për të zhvilluar aktivitetet elektorale. Me këtë të fundit, nuk parashikoj krimet elektorale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por gjithmonë e më shumë është e dyfishtë ambicia elektorale gjatë proceseve që kapin pushtetin vendor. Të paktën një perceptim i tillë është nga unë, ose të paktën nga modelet që na kanë ardhur kohët e fundit. Kështu, duke hequr limitin në tregojmë se kjo është e ligjshme, vetëm se duhet të jetë e bazuar në rregulla dhe partitë nuk duhet të kenë frikë të thonë se kanë financime, burime financiare apo mbështetje financiare përmes këtyre burimeve, por ato duhet ta respektojnë shtetin e së drejtës për çdo qindarkë që shpenzojnë, arkëtojnë, deklarojnë, raportojnë, auditohen e të tjera si këto.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Fjala për zotin Nard Ndoka!

Nard Ndoka - Faleminderit!

Dihet që financimi është shumë i rëndësishëm për fushatat elektorale. Ju dëgjova me vëmendje, por të them të drejtën nuk jam shumë i bindur te vëzhgimi që ju i keni bërë këtij procesi, edhe për faktin që po harxhohen shumë financa nga partitë kryesore politike, shumica e tyre janë informale, pra janë para që vijnë nga kanale të pista, janë sponsorizime me detyrim

nga kompani që janë afër partive në pushtet në shumicën e rasteve, gjë që e deformon totalisht tregun politik, konkurrencën politike, standardet, të cilat janë shumë të rëndësishme.

Duke e parë në këtë sens, ne kemi pasur fushata tej mase të ngarkuara, që janë pasojë e këtij financimi, kemi një garë të pabarabartë qoftë edhe me këto raporte të dorëzuara në KQZ, si obligim i ligjit, por dimë që janë miliona lekë, të cilat këto parti politike që përpiqen sot të bëjnë shtet, i përdorin në fushata elektorale në mënyrë informale, të padeklaruara dhe me burime të pista, gjë që krijon një lloj kontradikte edhe me qeverisjen dje, sot apo nesër në raport me këto financime.

Prita të dëgjoja të paktën që këto praktika do të marrin fund, apo të paktën të jenë në një shifër që është fare e thjeshtë për çdo parti politike, thjesht në numrin e takimeve (që janë publike), që ndiqen nëpërmjet medieve, numrin e flamujve, të billbordeve, të spoteve televizive, të pjesës sa kërkon një organizim i një takimi politik dhe sa është shuma që kanë harxhuar këto parti politike. Pra, kjo shumë është një e mijta e atyre që deklarohen në krahasim me të gjitha shpenzimet që kërkon një fushatë elektorale. Ndaj ka ardhur momenti (desha të dija opinionin tuaj, por thjesht prita ta thoshit si zgjidhje).

Ju dhatë shumë sugjerime, por jo atë që është kryesorja, që të kemi një financim nga buxheti i shtetit, nga taksapaguesit shqiptarë, për faktin që edhe ne, partitë e vogla votohemi dhe ata që na paguajnë ne, janë taksapagues. Në bazë të përqindjes së votave që merr çdo parti politike, merr një financim të qartë, transparent dhe taksativ dhe, përderisa ne nuk e kontrollojmë financimin dhe kemi institucione që u ushtrojnë presion bizneseve për t'i financuar partitë kryesore politike, besoj se kemi korrupsion të hapur brenda sistemit zgjedhor, deformim të konkurrencës dhe devijim të votës në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nëpërmjet këtyre financimeve.

Faleminderit!

Aranita Brahaj - Me sa kuptoj unë, çështja ishte për financimin e partive politike, përmes fondeve publike për partitë parlamentare apo partitë e përfaqësuara me votë.

Dakord, unë thashë që ne kemi edhe një argument më të detajuar për këtë pjesë dhe unë vazhdoj t'i qëndroj formës mikse për financim publik dhe jo financim privat.

Së pari, nëse do ta rrisim financimin publik për partitë politike, askush nuk do të na sigurojë që partitë përsëri nuk do ta thellojnë burimin e të ardhurave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ky është një argument. Argumenti tjetër është që asnjë taksapagues ...

Nard Ndoka – Ne e dimë sa shpenzojmë, pra kjo është një njësi matjeje. Nuk e dimë se sa do të vjedhin këto parti dhe nuk e bëjmë në këtë mënyrë. Nuk është argument ky.

Aranita Brahaj – Dakord. Argumenti tjetër është: ne duke pasur një formulë kaq fiktive, që raportohet vetëm një pjesë, ndërkohë që shpenzimet janë me bazë më të gjerë dhe këtë e evidentoni edhe ju, që jeni përfaqësues politikës, mendo sa e evidentojmë ne, që jemi hulumtues dhe aktorë civilë. Askush nuk do të na garantonte nëse ne do t'u jepnim partive jo 200 milionë lekë të vjetra, apo pak a shumë, kaq për partitë parlamentare me domethënie, por do t'u jepnim 3-5-10-fishin, këto parti nuk do të kishin apo kandidatët e tyre nuk do të kishin shtrirje tjetër financiare për t'i siguruar për t'i shpenzuar.

E dyta, asnjë taksapagues nuk është dakord të paguajë për partitë politike, kur nuk e gjen të përfaqësuar veten te asnjëra nga partitë, apo në rastin më të mirë, e gjen të përfaqësuar vetëm tek njëra.

Nard Ndoka – Ku e merrni të drejtën që flisni në emër të taksapaguesve, se na habite?!

Aranita Brahaj – Urdhëroni?

Nard Ndoka - Ku e merrni të drejtën që flisni në emër të taksapaguesve? Unë s'jam dakord.

Aranita Brahaj – Edhe unë jam taksapaguese.

Nard Ndoka – Edhe ju votoni për një parti politike. Ky është financimi më i drejtë. Ato janë standarde të vendosura në të gjitha vendet. Pse nuk merrni shembuj si e kanë vendet e tjera, si Gjermania, Italia etj.?

Aranita Brahaj – Unë po jap argumentet që mendoj unë.

Argumenti i tretë, do të ishte, që kjo do të ishte kundër natyrës së partive politike, sepse ato janë bashkime dhe organizime vullnetarësh që vijnë për qëllime përfaqësimi dhe njerëzit nuk duhet ta shohin veten të përfaqësuar te partitë politike vetëm në format që ato financohen dhe të bëhen si institucione buxhetore. Ky është mendimi im, të cilin po e argumentoj. Kam edhe argumente të tjera që mund t'i sjell me shkrim, sepse jemi thelluar një herë në një model. Ka edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2012 (nëse nuk gaboju), i cili është shprehur

në lidhje me këtë element. Megjithatë, unë jam këtu për të dhënë argumentet e mia edhe si taksapaguese, përveçse si aktore e shoqërisë civile.

Kam edhe argumente pro financimit publik, por në këtë peshore, mendoj se financimi miks do të ishte më i arsyeshëm dhe më i pranueshëm.

Oerd Bylykbashi – Ju falënderoj për sugjerimet që bëni!

Ka çështje tjetër?

Unë kisha 2-3 elemente.

Ju falënderoj për sugjerimet interesante që bëtë! Sigurisht, ka edhe materiale të tjera, edhe në tryezat e mëparshme në lidhje me financimin. Ne do t'i marrim të gjitha në konsideratë.

Sigurisht, në këtë histori ka një balancë të kujdesshme. Në fakt zgjedhjet janë shumë të thjeshta, por ne i komplikojmë rrugës. Fokusi i Kodit Zgjedhor dhe yni, është që së pari, të garantojmë procesin zgjedhor. Nëse Kodi Zgjedhor do të ketë më shumë pjesë, të cilat janë kapituj për financimin, që do ta bënin procesin zgjedhor paraprakisht pothuajse të pamenaxhueshëm, ndoshta do të ishim para një situatë pak problematike. Megjithatë, transparenca është e domosdoshme. Ka një qëndrim të hershëm të komisioneve zgjedhore, që dhe të bëjmë kujdes me fazën para për shkak se, ndërkohë që shpenzimet është mirë të deklarohen, burimet e financimit mund të jenë nën presion shtetëror, në rast se bëhen publike më përpara. Këtu nuk po futem fare në pjesën se sa janë në gjendje partitë politike t'i përgjigjen çdo lloj kërkesë, në çdo datë që vjen, nga çdo lloj subjekti, për të dhënë raportim financiar për shkak të së drejtës së informimit. Ashtu i bie të mos ketë shtab elektorale, por të ketë shtab raportimi financiar. Prandaj ne duhet ta shohim me kujdes për të bërë një balancë të kujdesshme të të gjithë kësaj.

Mua më tërhoqi vëmendjen ajo që thatë ju për rolin që kanë organizatat e treta, kryesisht OJF-të në proces, sepse në të shkuarën kemi pasur fenomene të llojit, ku OJF-të kanë bërë fushatë pasqyrë të partive politike. Disa janë të famshme, pavarësisht se mund të jenë edhe të shumëpranuara, edhe të shumëfinacuara. Kjo është e dëmshme dhe e parregulluar.

Po ashtu, kemi pasur situatën, ku OJF të financuara eventualisht edhe nga donatorët më pas, janë kthyer në parti dhe financimi i donatorit ka shërbyer praktikisht në një fushatë politike

(pa dashjen e donatorit). Pra është një terren i vështirë, i parregulluar, pra këto duhen parë me kujdes. Më vjen mirë që ju i përmendni si elemente që duhen parë.

Kisha edhe një pyetje, e cila del pak jashtë nga kjo, por gjithsesi ka të bëjë me raportin midis partive politike, shtetit dhe fushatës zgjedhore. Nga eksperiencia juaj a është e mundur të monitorohen në periudhat parazgjedhore rritjet e punësimeve në administratë (se në fund të fundit, është një shkëmbim), nëpërmjet të dhënave publike në thesarin e shtetit?

Aranita Brahaj – Fondi i pagave është diçka që artikullohet shumë qartë në thesarin e shtetit, sipas të gjitha institucioneve buxhetore. Problematike janë ndërmarrjet publike jobuxhetore, që realizojnë pagesa duke qenë të emëruara nga institucionet publike, bordet e tyre drejtuese, duke pasur asete publike në zotërim. Kjo duhet parë me shumë kujdes (ndoshta jo vetëm në kontekstin e këtij ligji), se ju jeni ligjvënës.

Pjesa tjetër është shumë transparente dhe mjafton që palët të kenë edukimin dhe emancipimin e duhur për ta monitoruar dhe për ta vlerësuar në mënyrë të përditshme. Një institucioni të rëndësishëm mund t'i shihet fondi i pagave në datën e caktuar në vitin 2016 dhe mund t'i krahasohet me datën e caktuar në vitin 2017.

Kjo nuk bëhet dot për ndërmarrjet, sepse ato nuk janë raportuese transparente. Ato raportojnë vetëm bilancet vjetore, të cilat janë ndonjëherë më të vonuara në publikimet pranë QKR-së, por edhe nuk i kanë këto lloj informacionesh. Kjo vlen edhe për reklamën, edhe për kontraktime të tjera, edhe për dhuratat e kompanive publike, edhe për format e shpenzimeve. Ndoshta do të ishte shumë interesante që Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese dhe ai i Ekonomisë ta shikonte pak më me kujdes për transparencën, madje edhe për mënyrën se si aplikohen klauzolat ligjore të privatizimeve në favor të palëve të autorizuara në këto ndërmarrje, sepse kemi hasur të tilla. Ne po tentojmë t'i hapim të dhënat. Kam dalë pak jashtë temës, por patjetër që shqetësimi qëndron edhe në kuadër të fushatave.

Ju shtruat një argument tepër interesant, por unë dua t'ju them se partitë politike në situatën e tyre më të vështirë të kapaciteteve njerëzore, pra të zyrave të financës, nëse bëjnë gabime apo kanë probleme të raportimit financiar më shumë se nga paaftësia apo nga kapacitetet e munguara të personelit, këto vijnë nga mungesa e vullnetit për rregulla brenda vetë partisë. Vërtet është e vështirë të bësh raportim *online*, por nëse kemi një llogari të caktuar për

donacionet, e cila përditësohet çdo ditë në bankë, nuk ka asnjë lloj vështirësie që kjo të jetë e vendosur *online* dhe të jetë e aksesueshme për publikun.

Nga ana tjetër, nëse kemi parti politike, që janë subjekte të deklarimit ekonomik pranë sistemit të tatim-taksave dhe futen çdo ditë apo çdo muaj për të bërë deklaratimet përkatëse, siç i bëjnë edhe OJF-të, çfarë vështirësie ka që këto të bëjnë deklarime në një sistem elektronik ose të bëjnë raportim *online* edhe për donacionet, edhe për shpenzimet, pra për burimet e shpenzimeve?

Po ashtu, dua të them se e kam ndjekur me kujdes mënyrën si është bërë raportimi *online* në faqen e KQZ-së nga partitë politike dhe mënyra si na kanë ardhur tabelat dhe struktura e raportimit financiar në raportet e auditimit të ekspertëve të pavarur dhe elementet apo defektet, ku partitë politike kanë dalë zbuluar në raportimin *online*, sepse është një klauzolë për raportim *online* në bazë të ndryshimeve ligjore të muajit maj 2017. Këto s'janë defekte që kanë të bëjnë me kapacitete e zyrave të financës, por kanë të bëjnë me vullnetin e partive politike për të qenë të qarta. Pra, të gjitha gabimet vijnë nga ato që quhen dhurime në natyrë, të cilat partitë nuk kanë tentuar fare t'i kontabilizojnë dhe meqë nuk e kanë bërë këtë në kohën e duhur, janë vonuar shumë, pasi kanë marrë rezultatet e monitorimit të ekspertëve të vendosur nga KQZ dhe kanë dalë zbuluar gjatë raportimit elektronik dhe janë detyruar t'i rinovojnë..

Mendoj se është shumë i nevojshëm raportimi *online*, sepse ai është një formë transparence, që u jep mundësi partive të jenë transparente në kohë reale, të mos kenë kohë të falsifikojnë apo për të riparë ose korrigtuar apo për të bërë korrigjime. Unë shpjegova se ka limite reale për të bërë raportimin financiar, por këto nuk duhet të jenë në kurriz të transparencës, të realitetit dhe të sinqeritetit. Kjo është fjala që përdorin kontabilistët në deklaratimin financiar.

Bledar Çuci –Faleminderit, zonja Brahaj!

Do të doja të kisha një përgjigje sa më koncize nga ju, lidhur me propozimin që ju bëtë për të hequr limitin apo tavanin e financimit. Ju e lidhët këtë me nevojën për të qenë më transparentë, më formalë, pra për t'iu shmangur formalitetit.

Megjithatë, ka edhe argumente kundër për limitet e financimit. Kryesisht kjo lidhet me barazinë, që duhet të kenë të gjitha subjektet politike. Dihet se aspiranti për pushtet apo ai që është në pushtet është gjithmonë është më atraktiv ndaj bizneseve për të dhënë donacione, por

unë do të doja të dija nëse keni bërë një analizë krahasuese se si mund të paraqitet (të paktën në vendet e rajonit) situata e limiteve apo jo limiteve të financimeve apo të donatorëve për partitë politike.

Faleminderit!

Aranita Brahaj – Mendoj se u kemi dhënë partive politike mundësi të barabartë për ta dhënë ofertën e tyre politike, bashkë me ofertën për kërkesën përmes votës apo përmes donacioneve. Ky është rregulli apo parimi më i qartë. Në fakt do të doja ta konsideroja si model fushatën amerikane, ku nuk ka limite, por ka vetëm detyrim për raportim, madje ka një ambicie të palëve për të raportuar sa më shumë, sepse është edhe ai rregulli që partia që arrin të marrë mbështetje më të gjerë përmes financimeve...

Bledar Çuci – Po nga rajoni? Amerika është shumë larg, është model tjetër. Një model më afër gjeografikisht.

Aranita Brahaj – Nuk më rezulton të kenë kufizime, megjithatë nuk po i përgjigjem kësaj pyetjeje, sepse nuk jam teknikisht e përgatitur. Megjithatë, mendoj se Shqipëria është rast për të arritur të paktën atë limit, sepse jemi realisht në kushtet e një limiti më të lartë.

Të mos harrojmë se bizneset janë ajo shtresë, e cila duhet të jetë më thellë në një proces, pra nëse jep mbështetjen për një forcë, për një program, apo për një metodologji të caktuar edhe të programit ekonomik të një partie, asgjë nuk duhet ta ndalojë biznesin të thotë, se është në rregull me elementët e vet dhe e jep një donacion dhe ka këtë lloj preference (sepse mund të jetë edhe një preferencë).

U fol edhe për organizata të shoqërisë civile, të cilat ndonjëherë dalin dhe artikulojnë, por organet e shoqërisë civile këtë punë kanë. Shpeshherë programet e tyre janë për mirëqeverisjen, për programe më të mira, për të drejtat e grupeve të interesit. Nëse paralelisht këtu janë në akordancë me partitë politike, këto të dytë janë politikëbërëse, ndërsa organizatat e shoqërisë civile janë presioni publik për politikëbërje më të mirë.

Patjetër, ka edhe raste të tjera, por mendoj se edhe akuza e fortë apo këndvështrimi që i sheh organizatat si instrumente të partive, nuk është i saktë, sepse organizatat janë aktorë të rëndësishëm, të cilët duhet të ndikojnë në bërjen e opinionit publik, në presionin publik.

Për pyetjen tuaj nuk ka modele të studiuara, por mendoj se në rastin e Shqipërisë, minimumi duhet rritur, sepse jemi në kushtet për ta bërë.

Bledar Çuci – Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Fjala për zotin Rama!

Luan Rama - Faleminderit!

Marr shkas nga një fjali që sapo e tha zonja Brahaj: “Nëse i shikoni organizatat e shoqërisë civile si instrumente të partive ...” .

Ne nuk i shohim si të tilla, por kur ato shfaqen si instrumente të partive, ne nuk mund të mos i shohim si të tilla. Ka më shumë sesa një rast të shfaqjes së organizimeve apo të strukturave, por edhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, në kundërshtim me interesin publik, me interesin qytetar dhe kjo e ka bërë jo më pak të kompromentuar rolin e një pjesë të tyre, ashtu siç ka bërë në fakt edhe rolin e subjekteve politike, por nuk është ky thelbi i diskutimit. Natyrisht, çështja e financimit të partive dhe e raportit të financimit të partive me ligjin është një problem i rëndësishëm, por nuk mendoj se kjo është çështja më e rëndësishme prej së cilës është krijuar i gjithë ai zinxhir problemesh që kanë zgjedhjet në Shqipëri. Zgjedhjet e kompromentuara, zgjedhjet e inkriminuara dhe zgjedhjet e kontaminuara edhe prej financimit me prapavijë kriminale, siç ka ndodhur për fat të keq, krijojnë kosto. Këto seanca dëgjimore natyrisht që e ndihmojnë komisionin për të krijuar një pamje reale, por gjykoj se racionaliteti i propozimeve tuaja, i konkretizuar edhe me draft konkret, me projekt konkret, do ta bënte bashkëpunimin tonë me efikas dhe do të na jepte komoditetin për ta administruar kohën më me efikasitet. Ju folët për 12 rekomandimet (nuk e kam thjesht me trupën që përfaqësoni ju, por me të gjithë ata që janë pjesë e këtij procesi), por nëse vini me një propozim konkret se çfarë duhet përmirësuar dhe si duhet bërë, do të shkëputeshim nga rekomandimet ex-katedra, pra që duhet të bëhet kjo, ajo, thjesht konstatime dhe në fund produktin do të duhet ta bëjmë ne. Kështu që mendoj, e kam për të dy bashkëdrejtuesit e komisionit, se duhet më shumë racionalitet dhe më shumë konkretësi në këtë proces për të qenë larg debatit, komenteve apo pyetjeve të bëra reciprokisht, të cilat nuk prodhojnë gjë.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Rama!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk shtroi çështje për ju, sepse kemi kaluar çdo limit të kohës.

Unë jam dakord që sa më konkrete të jenë të gjitha propozimet që vijnë, aq më shumë na ndihmojnë ne. Zoti Rama, do të kemi propozime, të cilat dalin jashtë mundësisë që kemi ne, ose që gjykojmë se janë të nevojshme për t'u trajtuar. Kjo fazë e konsultimit publik është e rëndësishme. Ju e theksuat këtë që në fillim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, besoj se me materialin që do të na sjellin, edhe siç kanë thënë organizatat e tjera, do të na ndihmojnë edhe ne ekspertët për të ecur para.

Kalojmë tek organizata tjetër.

Faleminderit, zonja Brahaj, për prezantimin dhe për përgjigjet që dhatë!

Fjalën e ka zonja Mirela Arqimandriti nga qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”.

Mirela Arqimandriti – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për ftesën për të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore!

Unë përfaqësoj qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, që është një qendër që merret me të drejtat e grave për avancimin e çështjes së barazisë gjinore në Shqipëri prej më shumë se 20 vjetësh. Kemi qenë pjesë e tryezave të tilla edhe në diskutimet për Kodin Zgjedhor të mëparshëm. Sistemet e ndryshme elektorale paraqesin sfida të ndryshme ndaj përfaqësimit të grave në zgjedhje, në lidhje me mundësinë e tyre për të konkurruar në zgjedhje dhe për t'u zgjedhur. Në përpjekjen më të fundit në Shqipëri për të filluar një reformë të re zgjedhore dhe për të ndryshuar potencialisht ndoshta edhe sistemin zgjedhor nevojitet një kuptim i plotë i rregullave zgjedhore dhe i mënyrë se si ato ndikojnë në përfaqësimin e grave. Ndërkohë që ekzekutimi i kuotave aktuale të gjinive mori dy cikle zgjedhjesh për t'u konsoliduar, një ndryshim potencial në sistemin zgjedhor do të paraqesë sfida të reja në këtë drejtim.

Përshëndesim arritjet e mëparshme në lidhje me përfaqësimin e grave në politikë dhe vendimmarrje dhe të gjithë deputetët, të cilët na kanë dëgjuar në vitet 2012 dhe 2015 për ndryshimet e propozuara në lidhje me përfaqësimin e grave në parlament. Gjithashtu, përshëndesim arritjen e grupit të grave parlamentare në vitin 2015, të cilat vendosën kuotën 50% për pjesëmarrjen e grave në këshillat bashkiakë, pavarësisht se përfaqësimi i tyre arriti deri në 34,6%. Sidoqoftë, në reforma shpesh neglizhohen kuotat gjinore. Ndaj iu desh të bënin më shumë përpjekje organizatave të shoqërisë civile, kryesisht organizatave të grave, për t'i sjellë

ato në vëmendje. Kështu që kësaj radhe ne do të përqijemi të jemi të vëmendshëm gjatë gjithës kohës që do të punoni që t'i merrni parasysh siç duhet çështje gjinore në këtë Kod të ri Zgjedhor që do të përgatitet. Ka dy aspekte: në qoftë se sistemi zgjedhor nuk do të ndryshojë dhe do të mbetet siç e kemi, rajonal-proporcional me lista të mbyllura, i aplikuar që në vitin 2008, atëherë dispozitat aktuale të kuotës gjinore duhet të përmirësohen dhe të konsolidohen.

Kjo reformë është një mundësi për të bërë në Shqipëri zgjedhje më të drejta nga këndvështrimi gjinor. Nëse do të jetë ky sistem elektoral, ne propozojmë barazimin e dispozitave të kuotave të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare dhe lokale, duke përcaktuar në Kodin Zgjedhor një kuotë 50% të kandidatëve dhe zbatimin e ndëshkimit me refuzim të listave për mospërputhje.

Sigurisht që përtej skenarëve të ndryshëm një model efektiv dhe afatgjatë që nuk do të varej nga sistemi zgjedhor do të ishte zbatimi i kuotave vullnetare në statutet e brendshme të partive. Megjithatë, kjo është një praktikë në politikat e brendshme të partive shqiptare që ne e kemi propozuar.

Përfaqësimi i grave në KZAZ-të dhe KQV-të

Sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor, që ndryshoi vetëm një muaj para fillimit të zgjedhjeve lokale 2015, listat për këshilltarë ishin të ndara në mënyrë të barabartë midis gjinive dhe të alternuara në çdo emër të dytë. Sidoqoftë, gratë mbeten të nënpërfaqësuara në organet drejtuese zgjedhore. Kur bëhej fjalë për KZAZ-në ne vlerësojmë faktin që si PS-ja, ashtu edhe PD-ja i respektuan kuotat gjinore të kërkuara nga ligji për përfaqësimin gjinor në komision në jo më pak se 30%. Pavarësisht ndërrimit të shpeshtë të komisionerëve para datës 22 muaj dhe deri në ditën e zgjedhjeve, partitë e mëdha e respektuan ligjin, partitë më të vogla nuk e bënë këtë. Gratë u përfaqësuan në disa pozita udhëheqëse në KZAZ me 14% ose 16% në poste kryetaresh, 21% në poste nënkryetaresh dhe 24% në postin e sekretareve. Gjatë ditës së zgjedhjeve gratë nuk ishin të përfaqësuara në 37% të komisioneve të qendrave të votimit dhe drejtuan vetëm 15%, pra vetëm kaq ishin kryetare. Edhe pse kjo nuk është një kërkesë e Kodit Zgjedhor, përfaqësimi i grave në organet e nivelit të tretë zgjedhor mbetet i papërfillshëm. Për këtë arsye Kodi Zgjedhor i Shqipërisë duhet të ndryshojë për të vendosur një barazi të plotë midis burrave dhe grave në procesin zgjedhor si kandidatë apo administratorë të zgjedhjeve, në mënyrë që të gjithë të mund t'i shfrytëzojnë plotësisht të drejtat e tyre të garantuara për pjesëmarrjen zgjedhore dhe publike.

Kodi Zgjedhor duhet të prezantojë të paktën të njëjtat kërkesa për kuotën gjinore edhe për partitë e vogla, që janë pjesë e KZAZ-ve; kuota gjinore duhet të futet në pozitat e nivelit të lartë të KZAZ-ve si poste për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe sekretarë.

Gjithashtu, unë doja të flisja pak edhe për të drejtat e personave më aftësi të kufizuara, meqenëse nuk është e pranishme organizata që i përfaqëson dhe ne e kemi monitoruar këtë situatë. Në vëzhgimin që kemi bërë në zgjedhjet lokale të vitit 2017 57% e qendrave të votimit në mbarë vendin nuk ishin të aksesueshme për votuesit me aftësi të kufizuara, gjë që, për mendimin tonë, është alarmante dhe administrata lokale dështoi në përpjekjen për heqjen e pengesave për votuesit me kufizime të lëvizshmërisë, duke dështuar në sigurimin e zgjedhjeve gjithëpërfshirëse dhe në promovimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë në to. Në fakt, aktualisht, përveç këtyre që i kemi të konsoliduara, jemi duke punuar për t'ju sjellë me shkrim të gjitha rekomandimet tona edhe në lidhje me reformën zgjedhore në organet e administrimit zgjedhor.

Sipas klasifikimeve ndërkombëtare të sistemit të organeve të administrimit zgjedhor, Shqipëria ka një model të pavarur të menaxhimit zgjedhor, që është KQZ-ja me një kombinim strukturash të përhershme dhe të përkohshme në periudhën zgjedhore. Organet e administrimit zgjedhor me bazë multipartiake janë modele tipike të menaxhimit të zgjedhjeve në vendet postdikatoriale, ku shërbimi civil shikohet si i korruptueshëm dhe partiak dhe balanca partiake e strukturave garanton njëfarë paanshmërie.

Megjithatë, mund të argumentohet se ky model nuk është më i përshtatshëm pas aplikimit për më shumë se dy dekada, duke qenë se modeli tashmë i shërben nxitjes së ndërtimit të partitizmit të proceseve zgjedhore. Kështu që propozimi i formave të depolitizimit të administrimit zgjedhor, për të cilat do të bashkëpunohet me partitë dhe jo kundër partive, është mirë të ndryshojë me rastin e këtij Kodi Zgjedhor, kështu që ne jemi duke përgatitur propozimet. Unë do të përmend vetëm dy-tri që i kemi draft, sepse grupi i punës nuk arriti t'i përfundonte para takimit të sotëm: reduktimi i detyrave të administratës zgjedhore nëpërmjet *outsourcing*, pra dhënies së detyrave të tretëve; procedura jopolitike për shpërndarjen dhe mbledhjen e materialeve zgjedhore; kontraktim të kompanive specifike apo shërbim privat në marrëdhënien privat-publik për këtë gjë. Gjithashtu, mendojmë të reduktohen gradualisht komisionerët dhe personeli me funksione partiake, si sekretar administrativ, funksionarë të emëruar nga KQZ-ja;

KQZ-ja të trajnojë dhe të certifikojë komisionerët dhe emërimi i tyre të bëhet me short, duke u dhënë partive vetëm një mundësi propozimi për komisionarë. Nëse ata duan t'i ndërrojnë, atëherë KQZ-ja të vendosë nga listat e atyre që ka trajnuar.

Shpresoj dhe jam e sigurt që komisioni *ad hoc* do t'i marrë parasysh të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it dhe të organizatave lokale që janë në Shqipëri. Ju premtoj se do t'i sjellim këto propozime me shkrim dhe të detajuara, pasi grupi i punës është duke punuar.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit për prezantimin konciz dhe për çështjet që ngritët për personat me aftësi të kufizuara! Në fakt, mbetet një problem, sepse dispozitat janë të vjetra, në mos gaboj të vitit 2003, kur edhe ka filluar për herë të parë Kodi Zgjedhor që i detyronte bashkitë për të krijuara situata të përshtatshme, gjë që ato nuk e bëjnë. Po ashtu, edhe KQZ-ja, ndoshta ne do të zhvillojmë një seancë edhe me të, mund të imponohet më fort për të detyruar pushtetin vendor të identifikojë qendra votimi në katet e para, sepse ka raste që nuk janë as në katet e para. Pra, kjo është një çështje që duhet të shikohet.

Për sa u përket çështjeve gjinore që ngritët fillimisht, sigurisht që në çdo rast të gjitha sugjerimet që bëhen duhet të kenë një lloj racionaliteti. E rëndësishme është që të kemi një sistem, i cili zhvillon përfaqësimin gjinor të qëndrueshëm në kohë dhe procesin zgjedhor e vë në baza normaliteti. Ne kemi rreth 40 mijë komisionerë, që do të thotë se 30% e tyre, rreth 12 mijë veta duhet të jenë femra. Nëse shkojmë te qendrat e votimit, ky numër mbetet shumë i madh përgjithësisht dhe është shumë i vështirë për t'u plotësuar. Kur kjo është e vështirë për t'u plotësuar nga aktorët që janë më të interesuar, aq më të pakta janë hapësirat për vullnetarizëm. Ne do t'i studiojmë mekanizmat për të parë se cila është mundësia më e mirë për t'i trajtuar këto elemente. Duke pasur parasysh edhe faktin që me një numër kaq të madh komisionarësh, 40 mijë, nëse partitë politike dështojnë, duhet që KQZ-ja të garantojë numrin, në mënyrë që procesi të mos bjerë në kolaps. Zgjedhësit në fund fare nuk i intereson se si administrohet, por të votojë dhe t'i numërohet vota. Nëse procesi kolapson për shkak të një kërkese, duhet që ne, sepse e kemi ne barrë, të gjejmë zgjidhje të qëndrueshme. Këto ishin disa komente, do të bëjnë edhe kolegët, ndoshta ju mund të shtoni diçka në materialet që do të na sillni.

Po, zoti Çuçi.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zonja Arqimandriti!

Në fakt, mund ta sjellësh edhe më vonë kur të dorëzosh dokumentin e plotë me rekomandimet, por do të isha shumë i interesuar të dija çfarë ndodh në rajon në lidhje me përfaqësimin gjinor. Domethënë, si është raporti i kuotave në vendet e Ballkanit Perëndimor, meqë është bërë edhe si koncept politiko-gjeografik, por edhe në Europë, sepse dihet që është një përpjekje e vazhdueshme për të pasur një balancim gjinor në përfaqësim, qoftë politik të parlamenteve vendore apo të parlamenteve kombëtare, qoftë pastaj edhe në administrimin e procesit zgjedhor? Në qoftë se keni diçka gati për rajonin, a është Shqipëria në vendet pararojë në lidhje me këtë çështje apo jo, do të kisha interes ta dëgjoja.

Oerd Bylykbashi – Ju lutem, zonja Arqimandriti!

Mirela Arqimandriti – Unë e përmenda pak se, për sa u përket vendeve europiane, si Suedia etj., të cilat janë në krye të listës për respektimin e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje, ato e kanë futur brenda partive politike. Ai është një model i cili nuk ndikohet nga Kodi Zgjedhor apo sistemi zgjedhor. Vetë partitë zgjedhin t'i kenë 50% të përfaqësimit gra. Ndërsa për rajonin ne do t'ju sjellim shifra të përditësuara, sepse, siç ndodh edhe në Shqipëri, ndryshimet e kodeve zgjedhore atje dhe reforma të tilla sjellin ndryshime edhe në përfaqësimin e grave. Ne kemi një studim të vitit 2015, të cilin do ta përditësojmë dhe do t'ju sjellim shifrat reale se si janë vendet e rajonit në lidhje me këtë çështje.

Oerd Bylykbashi – Zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Kam një pyetje për kuotën rozë, por e kam të lidhur me zgjedhjet lokale. Në qoftë se deri tani ne kemi zgjedhur që 50% e përfaqësuesve në këshillat bashkiakë të jenë të gjinisë tjetër, a shikoni se mund të ketë një instrument që të lehtësojë kandidimin e gjinisë tjetër në zgjedhjet lokale? Pra, deri tani këtë e kanë zgjidhur partitë, të cilat kanë mbështetur kandidatet femra, sidoqoftë ato mbeten shumë pak në raport me 61 kryetarë bashkie që kemi në Shqipëri. Besoj se ky instrumenti duhet të jetë i tillë që të mos cenojë të drejtën për të hyrë në garë, por edhe të drejtën e partive politike që ato të mbështesin kandidatët fitues, sepse në fund ky është interesi dhe qëllimi, pavarësisht se çfarë gjinie përfaqësojnë. Dua një opinion tuajin në lidhje me këtë gjë.

Mirela Arqimandriti – Në lidhje me kryetarët e bashkive, ne kemi sistemin tjetër, i cili jep mundësi popullit të zgjedhë në bazë të asaj që sheh dhe që paraqitet. Në këtë lloj sistemi

propozimi ynë është për të paktën 30% të përfaqësimit, pra partitë politike duhet të kenë si kuotë 30%, pra 30% e kandidatëve të jenë të gjinisë më pak të përfaqësuar.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Kam unë një pyetje: kur ju propozoni kuotën 50% (i përjashtojmë rastet e vendeve skandinave, sepse është një standard që nuk e arrijnë shumë vende), cilat janë ato vende në Europë, sepse nuk flasim dot për vendet që janë me sistemin “*first pas the post*”, sepse aty kuota nuk ka kuptim) apo kudo tjetër ku mendoni se ekziston kuota 50% me dispozitën që do të bënte refuzimin e listës (është taksative, ndryshe refuzohet), pra e cilësdo gjinie dhe jo vetëm e grave? A ka ndonjë model të cilit ne mund t’i referohemi?

Mirela Arqimandriti – Kur unë të sjell materialin e përgatitur, do të keni një rishikim literature dhe një tabelë me përfaqësimin e grave në politikë në disa vende, por argumentimi ynë lidhet me faktin se 50% e popullsisë përbëhet nga gra dhe 50% nga burra. Ky është argumenti më i mirë që edhe në politikë, edhe në vendimmarrje (nuk na intereson se çfarë ndodh në vendet e tjera apo se çfarë do të ndodhë, sepse vendet janë në zhvillim) gjinisë më pak të përfaqësuar dhe të djave së bashku t’u jepet mundësia të jenë të barabarta në momentin kur marrin vendime në lidhje me popullin që përbëhet 50% nga gra dhe 50% nga burra.

Ky është argumenti social dhe shoqëror.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Duhet të kemi parasysh se një koncept themelor në zgjedhje është konkurrimi. Nëse ne do të kishim kuotë, e cila mund të ekzistojë, e kemi për listat e pushtetit vendor, por nuk e kemi të detyrueshme nëpërmjet refuzimit. Do të kemi dy momente, të cilat duhen parë në raport me këtë lloj propozimi.

Së pari, konkurrueshmëria ndërmjet gjinive. Nuk do të kishim konkurrim. Nëse ne sot kemi mundësi që 30% dhe 30% janë të dyja gjinitë, dispozita jonë në Kodin Zgjedhor është shumë neutrale, ka një hapësirë që mbi bazën e aftësive dhe kapaciteteve individuale brenda partive politike raporti të jetë ndryshe, mund të jetë edhe 50% me 50%. Nga ana tjetër, duhet të shikohet edhe aftësia e partisë politike për të konkurruar në zgjedhje me kandidatët e saj më të mirë, siç e gjykon partia në mënyrë autonome për të parë aftësitë e saj, sepse në fund qëllimi

është fitimi i zgjedhjeve nëpërmjet zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe përfaqësimi më pas i elementeve të tjera që i garantojnë këto. Pra, duhet të shikohet edhe në këtë raport.

Të mos harrojmë që edhe futja e kuotave gjinore në dokumentet ndërkombëtare sugjerohet si një dispozitë transitore. Është një diskriminim pozitiv, por mbetet diskriminim, por si i tillë mund të jetë për një periudhë transitore. Ne kemi operuar me kuota permanente. Kam një pyetje: a keni konstatuar ju nëse partitë e kanë përcaktuar kuotën gjinore, pra a i kanë thënë KQZ-së: “Unë kam kuotën gjinore 30% burra ose 30% gra dhe kjo është kuota, këta janë në lista”? Ndryshe KQZ-ja e ka të pamundur të identifikojë se cilët janë kandidatë që duhet të ngjiten në rast vakance. Është një kërkesë e Kodit Zgjedhor. Ju a e keni studiuar këtë pjesë, ju rezulton të ketë ndonjë problematikë në lidhje me këtë zbatim nga partitë politike, apo jo? Pra, për çdo kuota gjinore, mashkull-femër, partia politike duhet të deklarojë se cila është kuota, se cilët janë emrat që mbrohen nga kuota, në mënyrë që të përdorë sistemin ZIP. A keni të dhëna për këtë?

Mirela Arqimandriti – E dhëna që ne kemi janë listat që kanë paraqitur partitë politike si në zgjedhjet lokale, ashtu edhe në zgjedhjet parlamentare dhe refuzimin e listave kur ato nuk janë bërë sipas Kodit Zgjedhor. Pra, në rastin e grave përfaqësuese në këshillat bashkiakë, ajo u zbatua, sepse ishte e shkruar në Kodin Zgjedhor me refuzim të listave, pra kishte një sanksion të rëndësishëm. Kjo nuk u zbatua përsëri, sepse emrat e parë të partive të vogla ishin burra dhe jo gra, kështu që ata krijuan këtë disbalancë. Kështu që nga të dhënat që kemi dhe nga ajo që ne kemi parë nuk na rezulton që partitë politike, përveç dorëzimit të listave, që i bëjnë në minutat e fundit, të kenë bërë edhe një analizë që kaq për qind të listave e kanë gra dhe kaq për qind burra. Kjo nuk bëhet nga partitë politike. Nuk e di a kuptova drejt pyetjen tuaj. Është vetëm një dorëzim listash dhe ajo analizë bëhet nga vetë KQZ-ja.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Nuk ka pyetje të tjera.

Mirela Arqimandriti – Unë kam vetëm një kërkesë të fundit. Në Kodin Zgjedhor është një nen i cili përcakton se në rastin kur dikush jep dorëheqjen nga posti i deputetit, ky person zëvendësohet me gruan që vjen në radhë në listë, pra këtë e dimë dhe kanë ndodhur disa problematika të ndryshme.

Oerd Bylykbashi – Nuk e ka këtë Kodi Zgjedhor. Është neutral Kodi, nuk thotë burrë, grua.

Mirela Arqimandriti – Jo, zëvendësohet ai që lë detyrën e deputetit...

Oerd Bylykbashi – Pyetja që ju bëra unë është pikërisht për këtë. Kodi Zgjedhor e mbron kuotën kur partia politike deklaron se cila është kuota. Le të themi, në qoftë se në listë ka 60% gra, duhet të thotë se cili është 30% që mbrohet nga kuota, ndryshe rregulli është kandidati i radhës. Doja të dija nëse keni studime për këtë, apo jo? Pra, ju thatë se nuk e keni parë këtë lloj elementi.

Mirela Arqimandriti – Nuk e kemi parë, por partitë politike nuk e kanë bërë këtë lloj analize asnjëherë, sepse në dokumentet që kemi marrë nga KQZ-ja për t'i studiuar për çështjen e kuotës zgjedhore, nuk ekziston.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Zoti Albieaj ka një pyetje që besoj se është e fundit.

Enkelejd Alibeaj – Kam një pyetje të thjeshtë. Pretendimi është që kuotat të jenë 50% me 50%, në varësi edhe të sistemit zgjedhor. Me këtë sistem proporcional apo një tjetër, a do të ishte e udhës, sipas opinionit tuaj apo sipas studimeve që ju mund të keni bërë, që kjo barazi të shkojë deri në absolutizëm të tipit nëse një parti politike vendos kuota jo vetëm në numër, por edhe në pozicionim, do të duhet që edhe partitë e tjera t'i përgjigjen po me të njëjtën ofertë që bëhet nga kjo parti? Po marr një rast hipotetik, nëse sistemi do të ishte maxhoritar dhe partia A vendos të kandidojë një grua, a do të duhej të ishte një detyrim edhe për partitë e tjera të kandidonin domosdoshmërisht gra për të shkuar te barazia? Opinioni tuaj apo studimi juaj ndalet thjesht dhe vetëm në kuotën 50% me 50% apo perfeksionohet edhe më tej?

E dyta, tashmë në Shqipëri, dhe jo vetëm, ka një lloj ndërgjegjësimi për fuqizimin e mbrojtjes së kuotave, pra të rritjes së përfaqësimit të grave, që, në opinionin tim, një mungesë e ofertës së një partie politike me kuotën gjinore të grave mund të përkthehet si një sinjal elektoral negativ për atë parti? A e keni edhe ju këtë lloj opinionin, apo jo?

Faleminderit!

Mirela Arqimandriti – Po e nis nga e dyta, nuk e kemi këtë opinion, sepse nuk ka se si të përkthehet në negativitet për një parti politike kur e përfaqëson popullsinë ashtu siç duhet.

Për pyetjen e parë nëse do të zbatohet sistemi majoritar, ne propozojmë që përveç kuotës ekzistuese, e cila nuk është e mjaftueshme për të garantuar përfaqësimin e grave nëse aplikohen listat e hapura, Shqipëria duhet të zbatojë kuotën e rezervimit të vendeve, 30% të jenë patjetër të rezervuara për gjininë më pak të përfaqësuar në parlament. Ky është propozimi ynë.

Oerd Bylykbashi – Kjo ishte pyetja dhe përgjigjja e fundit.

E mbyllim seancën dëgjimore për sot, duke falënderuar zonjën Brahaj dhe zonjën Arqimandriti për çështjet që shtruan, për propozimet që bënë dhe për përgjigjen që na dhanë!

Do t'ju njoftojmë përsëri për seancën e radhës.

MBYLLET MBLEDHJA